

RRJETI PËR ZHVILLIM RURAL I
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

e-buletini

no.09

Korrik - Dhjetor 2014



PUBLIKON

Rrjeti për zhvillim rural i
Republikës së Maqedonisë

"Kosta Veselinov" 3a, 1000 Skopje
R. e Maqedonisë
T: +389 (2) 3075 506
F: +389 (2) 3075 503
email: info@ruralnet.mk

www.ruralnet.mk



Në këtë numër...

- 1
faqe 3 **Suksesshëm përfundoi projekti për strategji komunale për ndryshimet klimatike në komunën e pehçevës**
- 2
faqe 4 **Aktivitete të Art Point – Gumno në periudhën korrik – dhjetor**
- 3
faqe 7 **Organizatë - anëtare e RZR e promovuar në Bit Fest**
- 4
faqe 7 **Aktivitete të realizuara të Fondacionit për zhvillim lokal dhe teknologji të informatikës - FLORIT**
- 5
faqe 9 **Aktivitetet e shoqatës “Kozjaçija vo srceto” në periudhën korrik – dhjetor 2014**
- 6
faqe 10 **Shënohet Etno dita e fermerëve të rinj në Republikën e Maqedonisë**
- 7
faqe 11 **Konferenca në temën: “Sfidat e gruas – sipërmarrëse në mjediset rurale”**
- 8
faqe 12 **Shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale**
- 9
faqe 13 **Trajnime të mbajtura për organizata anëtare të RZR të RM-së**
- 10
faqe 13 **Punëtori në teren në kopsht në f. Mllado Nagoriçanë**



- 11
faqe 14 **USAID publikon studim për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike**
- 12
faqe 15 **Prezantim i rezultateve nga projekti i USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike**
- 13
faqe 16 **Fotografia e projektit të USAID për Adaptim ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi e publikuar në kalendarin e USAID për Ndryshime globale klimatike 2015**
- 14
faqe 17 **Ishte mbajtur kuvendi i gjashtë i Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (RBZR)**
- 15
faqe 18 **Roli i rëndësishëm i bujqësisë familjare në vise rurale**
- 16
faqe 19 **Mbledhje e prepare: ngritja e zërit të Evropës rurale**



1

Suksesshëm përfundoi projekti për strategji komunale për ndryshimet klimatike në komunën e pehçevës

Në 18.12.2014 zyrtarisht përfundoi projekti Strategji komunale për ndryshime klimatike në komunën e Pehçevës. Përfundimi i projektit u shënuar me prerjen solemne të shiritit para Pallatit të kulturës “Jane Sandanski” në Pehçevë nga Drejtori i Misionit të USAID Xhejms Stajn dhe Kryetari i komunës së Pehçevës Igor Popovski. Me prerjen e shiritit edhe zyrtarisht u vënë në përdorim tashmë institucionet efikase energjetike në komunën e Pehçevës, pjesë të projektit “Efikasiteti energjetik në komunën e Pehçevës”, zbatuar si një prej prioriteteve të Strategjisë komunale për ndryshime klimatike në komunën e Pehçevës. Projekti ka përfshirë renovime me efikasitet energjetik dhe mbindërtime të ndërtesës komunale, shkollës fillore komunale “Vanço Kitanov”, kopshti i fëmijëve “7 Septemvri” salla e sportit “Jane Sandanski” dhe pallati i kulturës “Jane Sandanski”. Nëpërmjet përmirësimit të termoizolimit dhe instalimit të sistemit të nxehtësisë qendrore me peleta si dhe me përdorimin e poqëve me efikasitet

energjetik për dritat rrugore, bashkësia ka zvogëluar shpenzimet dhe emisionet e gazeve të serrave. Ndryshe, komuna e Pehçevës është komuna e parë që ka përpiluar Strategji për ndryshime klimatike dhe e njëjta është votuar nga Këshilli i komunës, dhe gjithashtu është komuna e parë që ka nisur dhe përfunduar zbatimin e pilot projektit që bashkësia e ka zgjedhur si më prioritar nga Strategjia. I tërë projekti është financuar nga USAID, zbatuar nga Milieukontakt Maqedonia, kurse partner lokal ishte Shoqatat – Qendër për bimë mjekuese dhe fruta të pyllit “Ambrozija” nga Pehçeva.

Në këtë ngjarje publikut ju drejtuan Kryetari i komunës së Pehçevës Igor Popovski, Drejtori i Misionit të USAID Xhejms Stajn, Drejtori ekzekutiv i Milieukontakt Maqedoni – Igor Slavkovski, si dhe koordinatori i Programit për grante të vogla për Fondin global ekologjik, Zlatko Samarxhiev i cili shfrytëzoi këtë rast të promovon projektin e ri – “Zvogëlim i CO2 dhe kursimi i mjeteve financiare nëpërmjet ndërrimit të lëndëve djegëse fosile me



burim të ripërtëritshëm të energjisë në institucionin parashkollor në Pehçevë” i cili filloi të zbatohet në komunën e Pehçevës si rezultat i bashkëpunimit mes Fondit global ekologjik dhe Milieukontakt Maqedoni, kurse zbatuesi është Shoqata – Qendër për bimë mjekuese dhe fruta të pyllit “Ambrozija” nga Pehçeva, kurse partner lokal janë komuna e Pehçevës dhe kopshti i fëmijëve “7 Septemvri” – Pehçevë. Projekti financohet nga UNDP dhe do të zgjat deri 30.11.2015.





Aktivitetet të Art Point – Gumno në periudhën korrik – dhjetor



1. Ekspozitë e veprave të fëmijëve – BIMËT E EGRA NGA RRETHINA IME

Si rezultat i inspirimit të fëmijëve nga bimët e egra të rajonit të malit Iline-Pllakena, në kuadër të IPA projektit “Lidhja e njerëzve me natyrën – përforsimi dhe rrjetëzimi i shoqatave qytetare në Maqedoni”, më 28 gusht, në kuadër të manifestimit tradicional “FESTIMI I PIREJIT”, ishte hapur ekspozita me titullin: **BIMËT E EGRA NGA RRETHINA IME**.


Ekspozita ishte vendosur në korridorin shkollës fillore “Vëllezërit Milla-dinovci” në f. Slloeshticë. Të pranishmit, përveç që kanë pasur mundësi të shohin krijimet e bukura të fëmijëve në letër dhe nga letra (vizatime, herbariume dhe origami), kanë dëgjuar edhe tre veprat letrare me çmim (dy vjersha dhe një gjëgjëze).

Kuratorë të ekspozitës ishin dy artistët që këtë vit ishin mysafirë rezidentë në APG: Kristine Nikoll nga Gjermania dhe Dik Roberts nga SHBA.



Pasuria e bimëve të egra nga rajoni që ishte vështuar me sytë e fëmijëve do të prezantohet në më shumë vende të shtetit. Deri më tani, kjo ekspozitë ka qenë në Demir Hisar dhe Manastir

(Qendra Kulturore e të Rinjve), ndërsa në bashkëpunim me partnerët tjerë lokal të projektit, të pasuruar me fotografi nga rajonet e tyre, do të vendoset edhe në Tetovë, Ohër dhe Shkup.



Në bashkëpunim me



Mbështetur nga:



Më tepër informacione në:

<https://www.facebook.com/groups/438266682933364/>



2. Festimi i Pirejit 8

Më 28 gusht 2014, në festën e Zonjës së Madhe, që është edhe mbrojtëse e fshatit Slloeshticë, kambana e Shën Atanasij, i ftoi vizitorët dhe respektuesit e Petre M. Andreevski dhe mesazhet e tij për durimin e qenies maqedonase në FESTIMIN E PIREJIT të tetë.

Festimi i këtij viti ishte në shenjë të 80 vjetorit të lindjes së madhit, që gjatë gjithë vitit, me kujtime të këndshme, festohet në më tepër vende të territorit.

Nderin e “qëndrimit” për Petre, këtë herë ju takoi anëtarëve të MakeDoks festivalit me një film kreativ doku-

mentar që këtë vit e kanë zgjedhur Slloeshticën dhe gumnon artistike për seli nga e cila kanë realizuar projektin e tyre “Kinemaja në Rrugë” nëpër fshatrat e rajonit të Demir Hisarit.

Në skenën “Ura Bella Reka” ishte zbuluar skulptura e regjisorit të theksuar Vllado Cvetanovski që ishte një prej udhëheqësve kryesore të manifestimit. Autori dhe donator i skulpturës është Zharko Basheski.

FESTIMI I PIREJIT ishte pasuruar me dy ekspozita dhe projektim të filmave nga MakeDoks.



3. Kinemaja në rrugë e pestë e “Makedoks”



Kinemaja në rrugë e festivalit me një film kreativ dokumentar “Makedoks” prej 17 deri 28 gusht ka pasur projekte të 18 filmave dokumentar në Krushevë dhe fshatrat Zhurçe, Xhvan, Edinakovci, Slepçe, Smi-

levë, Suvodol dhe Kutretinë, Sopotnice dhe Slloeshticë. Duke marrë parasysh interesin nga banorët lokal, Kinemaja në Rrugë, në gjitha fshatrat e rajonit të Dmter Hisarit në të cilat kaloi, ka arritur të realizojë misionin dhe të ndikojë mbi procesin e decentralizimit

të kulturës në vend dhe të mundësojë projekte më vende të vogla dhe rurale. Projektimi i fundit i Kinemasë në Rrugë të “Makedoks” mbahet në fshatin Slloeshticë më 28 gusht, ku bashkë me nikoqirët nga Art Point gumno kanë marrë pjesë në realizimin e manifestimit “Festimi i Pirejit” dhe në festimin e festës Zonja e Madhe.

Ashtu, ekipi i “Makedoks” ka qëndruar para varrit të madhit Petre M. Andreevski. Kinemaja në rrugë përfundoi në fshatin e tij të lindjes Slloeshticë. Jeta e vërtetë nga përrallat e filmave kreativ dokumentar e kemi projektuar në një realitet të ri, të zbuluar në lëndinat e malit Pllakenska. Filmi i shkurtë për Slloeshticë, zëri i gajdes së Angel petkovski nga Virova dhe filmi “Karpo patnik” i Ivanishin e kanë përmbyllur edicionin e tetë të kinemasë në të hapur. Fundi i kinemasë në rrugë ndoshta është një fillim i ri, zbulon dëshirë për të qëndruar këtu. E kemi vështirë të ndahemi nga kjo pjesë e bukur.



4. “Dëgjoni me zy të hapur katër” – homazh për Mishel Rabi

Në 10 vjetorin e vdekjes së ilustruesit francez, dizajnuesit grafik, piktorit, ëndërrimtarit dhe dashamirës i Maqedonisë – Mishel Rabi (në gusht 2004 hiri i tij ishte derdhur nëpër lëndinat e maleve

të Osogovës), në galerinë Art Point Gumno është shtrirë një ekspozitë prej 12 veprave të tij, pjesë e koleksionit privat të familjes Andreevski. Kspozita ishte hapur zyrtarisht më 28 gusht, në kuadër të manifestimit FESTIMI I PI-REJIT.



5. Punëtori ndërkombëtare arti/Rezidenca artistike 2014

Punëtorja ndërkombëtare e artit për këtë vit është një lloj i veçantë në vendin tonë, ishte zhvilluar në periudhën prej 26 gusht deri 20 shtator. Në gumnon artistike të Sloeshticës, kanë vepruar katër artistë me renome: **Kristine Nikoll**, një prej artistëve më të etabluar të skenës artistike gjermane; **Jan Triashka**, profesorë e vizatimit, grafikë digjitale dhe dizajn grafik në universitetin e Bratisllavës; **Aleksandar Pedoviq**, artist nga Serbia fqinje që kujdeset dhe zbaton qasje multi-disiplinare ndaj artit dhe dizajnit. Enigma e tij inspirimi është pyetja: Ku përfundon arkitektura, dhe ku është fillim i arteve vizuale? Mali Pllaken ishte enigma që inspiron edhe sot, pas përfundimit të punëtorisë në Sloeshticë; **Dik Roberts**, piktor, poet dhe muzikant nga SHBA që nga viti 2007 është banor rezident i Sloeshticës. Këtë vit, ai ndryshoi shprehjen e tij tipike abstrakte me paraqitje figurative. Më 13 shtator, dyert e studiot artistike në Art Point – Gumno ishin të hapur për



gjithë dashamirët e artit. Në studion e hapur ishin shëtitur më tepër se 150 vizitorë nga vendi, dhe kuptohet gjithë fëmijët nga Sloeshtica dhe rrethina. Përveç që kanë parë veprat artistike dhe kanë folur personalisht me autorët,

një pjesë e vizitorëve kanë pasur edhe mundësinë ekskluzive të provojnë “paprikash sllovaku” origjinal në kazanin që ish ambasadori i Sllovakisë në Maqedoni, z. Robert Kirnag e ka sjellë në Sloeshticë.



3

Organizatë - anëtare e RZR e promovuar në Bit Fest

Festivali tradicional i Manastirit Bit Fest këtë vit dallohet e program të pasur dhe të llojlojshëm. Përveç ekspozitave të ndryshme, koncerte dhe shfaqjeve teatrale, ishte organizuar edhe një panair të punimeve të dorës ku në mesin e mysafirëve të ndryshëm nga shumë shtete, kanë marrë pjesë edhe Etno Shop Beba si organizatë anëtare e Rrjetit për Zhvillim Rural. Në Shirok Sokakun e Manastirit kishte stoli të punimeve të ndryshme, Etno Shop Beba ka promovuar traditën maqedonase dhe kulturën duke ekspozuar veshjet e ndryshme maqedonase, kujtime dhe gjëra tjera interesante të përpunuara nga duart e shkathtë të grave anëtare të kësaj organizate.



4

Aktivitete të realizuara të Fondacionit për zhvillim lokal dhe teknologji të informatikës - FLORIT



Në periudhën korrik -dhjetor 2014, **Fondacioni për zhvillim lokal dhe zhvillim të teknologjive të informatikës - Gjevgjeli (FLORIT)** në suaza të projektit “Zhvillim i bursës elektronike për prodhime ushqimore bujqësore në rajonin ndërkufitar” (E-AUCTION), nëpërmjet Programit për bashkëpunim ndërkufitar mes Greqisë dhe Maqedonisë (2007-2013) realizoi dhe morri pjesë në disa ngjarje në partneritet me Odën ekonomike greko-italiane nga Selaniku, Oda ekonomike e Kukushit, Oda

greko-gjermane për industri dhe tregti dhe komuna e Kavadarit.

Ideja për projektin “Zhvillim i bursës elektronike për prodhime ushqimore bujqësore në rajonin ndërkufitar” (E-AUCTION) është bazuar në modelin e suksesshëm të bursës italiane në internet për shkëmbim të prodhimeve bujqësore dhe peshkut (BMTI), e cila është zhvilluar dhe drejtuar nga Shoqata e Odave tregtare italiane. Nëpërmjet platformës për ankandim elektronik, që është aktiviteti kryesor i projektit, do t’ju ndihmohet prodhuesve lokal që të përmbushin kërkesën e prodhimeve



dhe të arrijnë tek kanalet e reja për distribucion të prodhimeve. Gjithashtu, projekti parasheh mbështetje të prodhuesve lokal nëpërmjet trajnimeve individuale për përdorim të platformës.

Synimi kryesor është zhvillimi i ekonomisë në rajonin ndërkufitar nëpërmjet aktiviteteve me të cilat përdoren mundësitë potenciale të rajonit.

Më 06.09.2014 FLORIT morri pjesë në një roudshou e organizuar nga partneri, komuna e Kavadarit. Vjelja tradicionale e rrushit në tikvesh ishte mundësi e përkryer për të promovuar projektin E-AUCTION në Kavadar para vizituesve të shumtë. Përveç kësaj, partnerët nga ana greke e prezantuan platformën për



ankandim elektronik, funksionimin e saj dhe dobijnë nga ajo për prodhuesit, përpunuesit dhe blerësit e prodhimeve bujqësore.

Në Selanik, Greqi më 12.09.2014 u mbajt panairi ndërkombëtar Ekspo në të cilin komuna e Kavadarit bashkë me FLORIT, në stendin e vet i prezantuan synimet dhe aktivitetet e projektit. Prodhuesit e verës dhe mjaltes nga rajoni i tikveshit gjithashtu prezantuan prodhimet e tyre.

Më 06.11.2014, Fondacioni për zhvillim lokal dhe zhvillim të teknologjive të informatikës organizoi Konferencë në Gjevgjeli në të cilën morën pjesë partnerët e projektit, si dhe përfaqësues



nga kompanitë e Gjevgjelisë nga sektori ushqimor-bujqësor, përfaqësues nga NJR e Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujërave në Gjevgjeli, nga Agjencia për mbështetje dhe zhvillim të bujqësisë dhe qytetarë të tjerë të interesuar. Në Konferencë të pranishmit ishin të informuar për detyrat dhe synimin e projektit dhe kishin mundësi të shohin edhe prezantimet për platformën e ankandimit elektronik dhe të Udhëzuesit për investime, biznese inovative dhe procedura për eksportim. Në këtë ngjarje, partnerët e projektit realizuan edhe vizita në disa nga kompanitë më të mëdha ushqimore-përpunuese në Gjevgjeli, pronarët e të cilave shfaqën interes për përdorim të kësaj platforme elektronike.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Drejtori i FLORIT – Gjevgjeli më 19 dhe 20 nëntor morri pjesë në konferencën **“Transformimi i prodhimit lokal të ushqimit në procesin e aderimit në BE: mundësitë dhe sfidat” që u mbajt në Stamboll, Turqi** organizuar nga zyra e TAKSO në Turqi në bashkëpunim me zyrën maqedonase të TAKSO dhe përkrahur nga projekti ESSEDRA: “Zhvillim i qëndrueshëm ekologjik dhe socio-ekonomik në rajonet rurale”.

Në konferencë morën pjesë shoqata, fondacione, shoqata të fermerëve, kooperative, unione dhe rrjete të organizatave civile (OC) që punojnë në çështje që kanë të bëjnë me prodhimin lokal të ushqimit, siguria e ushqimit dhe biodiversiteti, prodhimi organik, bujqësi

që nuk rrezikon mjedisin jetësor/zhvillimin rural.

Ngjarja u përqendrua mbi mundësitë dhe sfidat që sjell procesi i aderimit në BE nga aspekti i prodhimtarisë lokale të ushqimit, përfshirë këto këndvështrime:

- Pjesëmarrja e OC, gjatë procesit të aderimit, në vendimmarrjet mbi rregulloren për qasje tek ushqimi lokal dhe prodhimi lokal i ushqimit
- Politikën e BE-së dhe të shteteve pjesëmarrëse për prodhimin e qëndrueshëm lokal të ushqimit përfshirë standardet e prodhimit, kushteve higjienike dhe kërkesat, marketingu, si dhe zbatimi i tyre.

- Qasje tek përkrahja dhe sistemet mbrojtëse në vendet aderuese dhe sidat që dalin nga industrializimi në politikën bujqësore përfshirë rregulloret për organizma gjenetiksht të modifikuar në prodhimin e ushqimit.
- Roli dhe bashkëpunimi i OC në ruajtjen e bio-diversitetit të ushqimit gjatë procesit para aderues.

Në këtë konferencë u shkëmbyen praktika të mira nga GO, kurse drejtori i FLORIT – Gjevgjeli veçanërisht theksoi mundësitë për e-veglat e reja për marketing të prodhimit lokal të ushqimit.

Ngjarja ishte financiarisht e mbështetur nga programi i BE-së “Njerëz për njerëz”.



5

Aktivitetet e shoqatës “Kozjaçija vo srceto” në periudhën korrik – dhjetor 2014

Shoqata “Kozjaçija vo srceto” në periudhën prej korrik deri në dhjetor ka pasur shumë aktivitete në fushën e ekologjisë, siç ishte pastrimi i deponive të paligjshme në disa fshatra të Kozjaçijës.

Aktiviteti më i madh i Shoqatës në këtë periudhë ishte organizimi i Manifestimit “Bajlovski Sredbi”, për herën e gjashtë.

Manifestimi u mbajt në 28 - shtator 2014 (e diell) para Shtëpisë së shoqatës në fshatin Bajllovcë. Numri i të pranishmëve në Manifestim ishte mbi 1500 persona.

Manifestimi pjesërisht ishte i financuar nga Rrjeti për zhvillim rural në Republikën e Maqedonisë, si dhe nga Komuna



e Staro Nagoriçane.

Në Manifestimin e këtij viti, u mbajtën këto aktivitete:

- Lojëra zbavitëse popullore-sportive;
- Garë për më të mirë të përgatitur në mënyrë tradicionale;
- Dasmë e vjetër Kozjake-Bajllovike, me performanca të tri shoqatave kulturore –artistike dhe prezantim të zakoneve të dasmave dhe veshjeve nga rajoni i Kozjakut;
- Program kulturo dhe artistik;
- Drekë e përbashkët dhe shoqërim të pjesëmarrësve dhe mysafirëve në Manifestim nga të gjitha viset e Maqedonisë dhe më gjerë.





6

Shënohet Etno dita e fermerëve të rinj në Republikën e Maqedonisë



Me bashkëpunim të përbashkët mes Federatës së Fermerëve të Republikës së Maqedonisë (FFRM), Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë (RZR i RM-së) dhe organizata e saj anëtare, shoqata Horti Eko, më 26 tetor në v. Mokrino, rrethina e Strumicës, ishte organizuar manifestimi i këtij viti "Etno ditë për fermerët e rinj në Maqedoni". Ngjarja ishte pasuruar me paraqitjen e grupeve muzikore dhe të vallëzimit nga Maqedonia dhe Bullgaria fqinje. Në shumë pjesë ishin shfaqur fotografi të gjitha manifestimeve që janë mbajtur deri më tani me rastin e ditës së fermerëve të rinj si dhe vizatime nga fëmijët e shumë shkollave të rajonit të Strumicës.

«Ndonëse në shikim të parë duket që fermerët e rinj në vendin tonë janë gjithnjë e më pak, ata sërish paraqesin një pjesë e rëndësishme për zhvillimin e sektorit bujqësor në Republikën e Maqedonisë. Niveli i inovacionit, guximi dhe entuziazmi, që janë një karakteristikë e të rinjve, janë njësoj të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë bujqësore, si dhe për zhvillimin rural të bashkësisë lokale ku edhe ata veprojnë: - theksoi në fjalimin e saj hyrës, Marija Trpevska, përfaqësuesi i Rrjetit për Zhvillim Rural të Republikës së Maqedonisë. Përveç asaj, fjalime

kanë pasur edhe Nikolla Stamenov, kryetar i FFRN-së, Tome Timov - koordinator i FFRM-së dhe kryetar i shoqatës Horti Eko dhe përfaqësuesi i Prokredit Bankës, që theksuan rolin e rëndësishëm që kanë fermerët e rinj në ruajtjen e traditës dhe trashëgimisë kulturore.

Qëllimi përfundimtar i ngjarjes ishte të promovohet rëndësia e iniciativave dhe aktiviteteve të të rinjve në ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisve rurale si dhe të inkurajohet një pjesëmarrje të përbashkët dhe pro-aktive në përmirësimin e sektorit bujqësor në vend.

Një ditë më parë, më 25 tetor, në Strumicë ishte mbajtur mbledhja vjetore e Rrjetit të Fermerëve të Rinj i FFRM-së. Në takim ishin të pranishëm më tepër fermerë të rinj dhe banorë të rajonit të Strumicës, para të cilëve foli Nikolla Stamenov, kryetar i FFRM-së dhe Marija Trpevska, si përfaqësuese e Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë. Vllado Srbinovski, kryetar i Ballkanija - Asociacioni Ballkanik për Truizëm Alternativ, ka pasur prezantimin e tij në temën «Perspektivat e popullatës së re rurale në agro-turizmin në Maqedoni». «prof. Dr. Vjekosllav Tanaskoviq nga Fakulteti i Shkencave Bujqësore dhe Ushqim ka ndarë disa prej rezultateve të arriturave nga aktivitetet e zbatuara në kuadër të projektit të

USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, i zbatuar nga RZR i RM-së. Ai i njoftoi të pranishmit me ndikimin e ndryshimeve klimatike mbi prodhimtarinë bujqësore dhe ka dhënë sqarim për masat për konservimin e ujit, që është e nevojshme për të zvogëluar efektet dëmtoese.

Fermeri i ri dhe kryetar i shoqatës Horti Eko, Tome Timov, pa përfundimit të takimit, për vizitorët ka organizuar shëtitje dhe vizitë të pasurive natyrore që ofrojnë mjediset rurale në rrethinën e Strumicës. Ishin vizituar 2 manastire në fshatrat Vodoqa dhe Veljusa, që dallojnë prej shekujve IV dhe XI.





7

Konferenca në temën: “Sfidat e gruas – sipërmarrëse në mjediset rurale”



Më 14 tetor 2014 në qendrën Multikulti, Koçanë, Rrjeti për Zhvillim rural i RM-së dhe Federata e Fermerëve në RM kanë organizuar konferencën në temën “Sfidat e gruas – sipërmarrëse në mjediset rurale”. Ngjarja kishte për qëllim të nxit sipërmarrjen tek gruaja rurale, duke ngritur vetëdijen e tyre për sfidat dhe mundësitë që ofrojnë mjediset rurale/

Vaska Mojsovska nga f. Temjanik, rajoni i Negotinës, Vesna Petrova nga f. Lesnovo dhe Ana Paçemska nga Berova kanë shkëmbyer shembujt e tyre pozitiv si gra

të suksesshme sipërmarrëse nga mjediset rurale.

Në pjesën e dytë të ngjarjes, përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit kanë prezantuar IPARD programin, pas të cilës vijonte një diskutim ku të pranishmit kanë pasur mundësinë të parashtrojnë pyetje dhe të shkëmbejnë problemet dhe vështirësitë me të cilat përballohen gjatë aplikimit. Përfaqësuesit e MBPEU-së kanë shprehur gatishmërinë e tyre për bashkëpunim dhe kanë ftuar të interesuarit që të drejtohen tek ata për këshilla dhe konsultime në procesin e përgatitjes së aplikacioneve të tyre.



Shënohet Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale

Më 15 tetor 2014, në f. Mojanci, Koçanë për herën e parë në vend ishte shënuar Dita Ndërkombëtare e Gruas Rurale. Manifestimin tradicionalisht kanë organizuar Federata e Fermerëve e RM-së dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i RM-së për të theksuar rolin e gruas në zhvillimin bujqësisë dhe viset rurale.

Këtë vit evenimenti ka mbledhur më tepër se 300 gra nga pjesët e ndryshme të Maqedonisë. Para të pranishmëve u drejtuan Ratko Dimitrovski – Kryetar i Komunës së Koçanës, Nikolla Stamenov – Kryetar i FFRM dhe Petar Gjorgievski – Kryetar i RZR i RM-së.

Gordana Mitrovska-Beba – kryetare e shoqatës Etno Beba nga Kumanova, anëtar e RZR e RM-së, Vaska Mojosovska – fermer nga f. Timjanik, rajoni i Negotinës dhe Lubica Xhoniq, koordinatori i rrjetit të grave pranë FFRM, duke shkëmbyer përvojat e tyre pozitive, dërguan apel drejt grave të viseve rurale për nisjen e iniciativave të përbashkëta dhe veprimi i bashkuar për realizimin e interesave të përbashkëta. Ata kanë theksuar rëndësinë e nxitjes dhe zhvillimit të sipërmarrësish tek gruaja rurale dhe rëndësinë për përmirësimin e ekonomisë në mjediset rurale.

Në kuadër të manifestimit ishte organizuar edhe një garë në përgatitjen e tavës tradicionale, në të cilën kanë marrë pjesë 8 gra nga mjediset e ndryshme dhe kanë demonstruar shkathësitë e tyre dhe njohuritë për kuzhinën tradicionale.





9

Trajnime të mbajtura për organizata anëtare të RZR të RM-së

Si pjesë e aktivitetit për ngritje të kapaciteteve të Rrjetit për Zhvillim Rural të RM-së, e zbatuar në kuadër të projektit të USAID për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike, më 7 dhe 8 korrik në Shkup ishin organizuar dy trajnime në të cilat ishin ftuar organizatat anëtare të RZR të RM-së. Qëllimi i trajnimeve ishte përmirësimi i shkathtësive

komunikuese dhe prezantuese si dhe përfitimi i njohurive të reja në pjesën e menaxhimit financiar të projekteve. Gjithsej 19 përfaqësues të shoqatave qytetare në mënyrë aktive kanë marrë pjesë në trajnimet, duke konfirmuar përfitimet nga këto dhe duke shprehur interes për realizimin e trajnimeve të reja në tema të rëndësishme për punën e tyre.



10

Punëtori në teren në kopsht në f. Mllado Nagoriçanë



Në kuadër të projektit të USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike më 3 shtator, në fshatin Mllado Nagoriçanë ishte organizuar një punëtori në teren. Ngjarja u zhvillua në kopsht me dardha në të cilën projekti ka bërë testime me teknika të ndryshme dhe masa për adaptim ndaj ndryshimeve klimatike.

Në punëtorinë kanë marrë pjesë 20 këshilltarë të ANZHB-së (Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë) nga pjesë të ndryshme të territorit.

Ekspertët teknik nga fusha e pemëtarisë, në fushën e testimit të krijuar nga projekti ka zhvilluar një kombinim të seancave teorike dhe praktike edukative. Para pjesëmarrësve ishte sqaruar rëndësia dhe përfitimet e përdorimit të masave të ndryshme adaptive si UB rrjete mbrojtëse, kultura për çati, shtresa rrezistent ndaj tharjes dhe mulçimi. Të pranishmit gjithashtu kishin mundësinë të krahasojnë dëmet e shkaktuar nga breshri tek dardhat që nuk janë të mbrojtura me UV rrjete me ata që kanë instaluar UV rrjete. Përdorimi i rrjeteve mbrojtëse ka rol të dyfishtë, gjegjësisht ka treguar rezultate të shkëlqyeshme në uljen e djegieve nga dielli si dhe mbrojtje të kulturave nga breshri. Ishin mundësuar këshilla të shumta dhe instruksione për zbatimin e praktikave të ndryshme bujqësore adaptive nga ana e ekspertëve, me qëllim të mundësojnë fermerëve të mbrojnë kulturat pemore nga ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike.





11

USAID publikon studim për Adaptimin e Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike



tar Gjeorgievski, ndërsa prof. Dr. Ordan Çukaliev dhe prof. Dr. Sreten Andonov kanë bërë një prezantim të shkurtë të zbulimeve nga dy studimet.

Projekti trevjeter i USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike filloi të zbatohet në prill të vitit 2012 nga ana e Rrjetit për Zhvillim Rural të RM-së. Qëllimi i projektit është të ndihmojë fermerët të adaptohen ndaj ndryshimeve klimatike dhe të ruajnë nivelin e rendimentit me anë të uljes së dëmeve të shkaktuar nga ndryshimet në mjedisin jetësor. Aktivitetet e projektit janë të fokusuar në zonën mesdhetare përfshirë edhe rajonin e Vardarit me pjesë të rajoneve të Strumicës dhe Gjevgjelisë - fusha bujqësore që janë nën ndikimin më të madh të ndryshimeve klimatike.

Më 5 nëntor, ishte mbajtur prezantim i dy studimeve për ndryshime klimatike të publikuar nga projekti i USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike - njëra është fokusuar në efektet e ndryshimeve klimatike në sektorin bujqësor në Maqedoni ndërsa tjetra është me fokus në ndikimet negative mbi blegtorinë. Studimi për blegtorinë është e para e këtij lloji në Maqedoni.

Zbulimet ishin ndarë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit (MBPEU), me rreth 50 fermerë, tregtarë, furnizues dhe përfaqësues të shoqatave bujqësore, institucione akademike, joqeveritare dhe do të jenë të gatshëm për gjithë palët e interesuara në sektorin bujqësor. Studimet sigurojnë informacione themelore të cilat do të përdoren në iniciativat e ardhshme për adaptimin e bujqësisë dhe prodhimtarinë bagëtoresh dhe do të shërbejnë si dokument relevant, posaçërisht për MBPEU-në, në krijimin e politikave lidhur me ndryshimet klimatike dhe aktivitete për përshtatjen e bujqësisë.

“Ndryshimet klimatike janë prioritet për qeverinë e SHBA-ve në botë”, tha drejtori i misionit të USAID- Xhejms Shtajn. “Këtu në Maqedoni, ne ju ndihmojmë fermerëve individual të zbusin efektet e ndryshimeve klimatike”. Në fund, ai inkurajoi fermerët të ndjekin rekomandimet e dobishme që janë dhënë në raportet.

Para të pranishmëve u drejtuan edhe zëvendës ministri për bujqësi Vanço Kostadinovski, drejtori i projektit të USAID për adaptimin e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike, Pe-





12

Prezantim i rezultateve nga projekti i USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike

Më 7 nëntor, në sajë të Panairit Ndërkombëtar për Konsumim të Gjerë "Agrofood" në Shkup, me fillim në orën 11: Rrjeti për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Panairin e Shkupit ka organizuar një punëtori për të prezantuar rezultatet e fituar nga aktivitetet e deritanishme të zbatuara me anë të projektit të USAID për Adaptim të Bujqësisë ndaj Ndryshimeve Klimatike. Profesorët e Fakultetit për Shkenca Bujqësore dhe Ushqim kanë shpërndarë rezultatet dhe arritjet nga zbatimi i masave adaptive në pemëtarinë, kopshtarinë dhe vreshtarinë, si dhe zbulimet nga dy studimet e publikuara për adaptim të bujqësisë dhe të prodhimit të bagëtore në kuptim të ndryshimeve klimatike. Gjithashtu, qëllimi i evenimentit ishte të rrit vetëdijen e prodhuesve bujqësor, por edhe gjithë publikun e gjerë, për sfidat dhe efektet e ndryshimeve klimatike në sektorin bujqësor në Republikën e Maqedonisë.

«Aktivitetet e deritanishme dhe të ardhshme të këtij projekti janë hapa pioniere në fushën e masave adaptive për përbalim me efektet e ndryshimeve klimatike në bujqësi dhe konsiderojmë që dukshëm do të ndihmojnë në përmirësimin e praktikave të qëndrueshme të sistemeve bujqësore në Republikën e Maqedonisë», deklaroi Petar Gjorgievski, kryetar i Rrjetit për Zhvillim Rural i RM-së dhe drejtor i projektit.

Në prezantimin kanë marrë pjesë mbi 100 fermerë, përfaqësues të ANZHB-së (Agjencia për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë), shoqata bujqësore, organizata joqeveritare, institucione shkencore dhe arsimore.





13

Fotografia e projektit të USAID për Adaptim ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi e publikuar në kalendarin e USAID për Ndryshime globale klimatike 2015

Projekti i USAID Adaptim ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi në tetor dorëzoi 4 fotografi me përshkrime të aktiviteteve të projektit, për USAID Konkursin e fotografive të ndryshimeve klimatike. Vendimi që fotografia e projektit USAID ANKB do të përfshihet në Kalendarin e USAID për Ndryshime globale klimatike 2015, së bashku me 13 fotografi tjera nga USAID projekte në mbarë botën u shpall në dhjetor. Koleksioni i USAID fotografive më të mira klimatike nga viti 2014 do të shfaqet për zyrtarët e lartë dhe qeverinë amerikane, lider afarist dhe të OJQ-ve nga më shumë se 100 vende në bisedimet mbi klimën në KB në 2014. Kalendarin gjithashtu është botuar në ueb faqen dhe Facebook profilin e RDN dhe e shpërndarë me Facebook profilin e USAID Maqedonia.



MAY 2015

NOVO SELO, MACEDONIA

PHOTO: Aleksandra Todorovska

In the rural village of Novo Selo, an elderly man learns about affordable techniques to adapt crops for climate change. About half the people in rural Macedonia depend on small farms and orchards, and harvests are highly sensitive to climate variations and weather extremes. USAID is working with small farmers to develop and disseminate affordable practices to protect crops from current and future risks, including hotter temperatures, droughts, floods and storms. Simple techniques like placing nets over orchards to block ultraviolet radiation have already proven useful in protecting fruit from hail and sun damage. A "caravan" of climate change experts periodically travels the countryside, distributing information and hosting open question-and-answer sessions with farmers. These benefits stem from non-climate programs.

LEARN MORE www.usaid.gov/macedonia/fact-sheets/adaptation-climate-change-agriculture

S	M	T	W	T	F	S
26	27	28	29	30	1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31	1	2	3	4	5	6



GLOBAL CLIMATE CHANGE INITIATIVE



14

Ishte mbajtur kuvendi i gjashtë i Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural (RBZR)

Më 5 dhjetor 2014 në Bansko, Bullgari, ishte mbajtur seanca e gjashtë kuvendore e Rrjetit Ballkanik për Zhvillim Rural në të cilën ka marrë pjesë edhe kryetari i Rrjetit për Zhvillim rural i Republikës së Maqedonisë, Petar Gjorgievski.

Gjatë kuvendit të gjashtë të RBZR-së, anëtarët e RBZR-së kanë diskutuar mbi aktivitetet e realizuar në periudhën shtator –dhjetor 2014, aktivitetet e planifikuar për vitin 2015 në pajtim me planin e veprimit të RBZR dhe vendimet për anëtarësim.





Roli i rëndësishëm i bujqësisë familjare në vise rurale

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Rrjeti për Zhvillim Rural i Malit të Zi me mbështetjen e Grupi i Përhershëm i Punës për EJT për Zhvillim Rural (GPP) kanë organizuar bashkërisht një konferencë mbi Bujqësinë familjare me titullin “Roli i rëndësishëm i bujqësisë familjare në viset rurale”. Konferenca u përqendruar kryesisht në rolin e rëndësishëm të bujqësisë familjare, sfidat kryesore dhe prioritetet për të ardhmen, si dhe shqyrtimin e mjeteve dhe mënyrave më të mira për mbështetjen e fermave familjare. Konferenca u zhvilluar më 1 korrik 2014 në Podgorica, Mal i Zi. Qëllimi i konferencës ishte të nënvizohen qartë mjediset ekonomike dhe sociale të fermerëve familjar në rajon. Me mbledhjen e përfaqësuesve të Ministrive të Bujqësisë nga rajoni i vendeve të EJT, gjegjësisht institucionet anëtare të GPP, Rrjeti Ballkanik për Zhvillim Rural me organizatat, përfaqësuesve të organizatave të fermerëve familjar, kooperativave dhe organizatave të prodhuesve, sektorit privat, etj, konferenca kishte për qëllim të shqyrtojë çështjet e bujqësisë familjare jashtë spektrit të



tyre. Secili vend pjesëmarrës, përfshirë edhe Maqedoninë, ka pasur një prezantim të shkurtë mbi situatën momentale të sektorit bujqësor dhe bujqësisë familjar si pjesë integruese. Përveç kësaj, vëmendje të madhe ka tërhequr prezantimi i zotit Zoltán Kálmán, Shefi i Departamentit, Ministria e Bujqësisë në Hungari i cili bëri një pasqyrë të rezultateve kryesore të “Forumit Global

dhe Panairit mbi Bujqësinë Familjare” që ishte organizuar në Budapest prej 4 deri 6 mars 2014. Gjithashtu, prezantimi tjetër i z Kálmán, “Sfidat kryesore dhe mundësitë për investime bujqësore në bujqësinë familjare. Ku jemi ne në kuptimin global dhe rajonal?” provokoi shumë diskutime, duke bërë një përqendrim në vendin e tij amë - Hungarinë.



Mbledhje e prepare: ngritja e zërit të Evropës rurale

Përfaqësuesi i Rrjetit për Zhvillim Rural i Republikës së Maqedonisë ishte një prej njëzet përfaqësuesve të vendeve të ndryshme evropiane që kanë marrë pjesë këtë vit në Mbledhjen PREPARE, që ishte mbajtur në Finlandë dhe Estoni, gjatë periudhës prej 5 deri 9 shtator. Përfaqësuesit e më tepër lëvizjeve rurale kombëtare dhe rrjete kanë pasur mundësinë të mësojnë më tepër dhe të shkëmbejnë përvoja në kuadër të temës: “Ngritja e zërit të Evropës Rurale”.

Ngjarja ishte organizuar në formë të vizitës dyditëshe në teren në mjediset rurale në rrethinën e Helsinkit dhe Talinit, vijuar nga një konferencë njëditëshe më 8 shtator. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të shohin më tepër praktika të mira dhe iniciativa në mjediset rurale në periferi të qyteteve të mëdha. Organizatat SITI nga Finlanda dhe KODUKANT nga Estonia, si partnerë të PREPARE kanë prezantuar punën e tyre dhe kanë sqaruar si në vendet e tyre e menaxhojnë procesin kaskadë të shkëmbimit të ideve dhe interesave mes niveleve lokale, rajonale dhe kombëtare.

Konferenca e mbajtur në Talinë ishte fokusuar në procesin e përgatitjes së Parlamentit Rural Evropian (PRE) të dytë që do të mbahet në vitin 2015. Suksesi i PRE-së së parë të mbajtur në Bruksel në vitin 2013 që mbledhi 150 përfaqësues nga 30 vende, ka inkurajuar PREPARE dhe ERKA të vazhdojnë iniciativën. Ishin shpërndarë qëllimet kryesore të PRE dhe përvojat e organizimit të parlamenteve të ndryshme



kombëtare rurale. Në sajë të punëtorive, grupet e punës kanë diskutuar për çështje të caktuar të cilat kanë të bëjnë me popullatën rurale me qëllim të njëjta të shqyrtohen nga PRE-ja. Gjithashtu, ishte biseduar për procesin kaskadë të mbledhjes së ideve në nivelin lokal dhe bartja e tyre në atë kombëtar, si dhe për mundësitë e financim-

it të Parlamentit Evropian Rural që do të mbahet.

Të gjithë të pranishmit kanë mbështetur iniciativën dhe ishin dakord që të angazhojnë resurset e tyre në sintetizimin e ideve dhe problemeve të popullatës rurale në vendet e tyre, me qëllim të ndihmojnë procesin e organizimit të PRE-së së dytë.